



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE
SIGURINË KIBERNETIKE

Nr. 86 Prot.

Tiranë, më 06.02.2024

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË
DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS

Nr. 16/2 Prot.

Tiranë, më 06.02.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet midis palëve:

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, (në vijim referuar si AKCESK), me adresë "Rruga Papa Gjon Pali II", Kati i parë, Nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Igli Tafa,

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, (Në vijim referuar si ASHMDF) me adresë "Rruga e Durrësit, Nr. 83, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetar znj. Alma Tandili,

Në vijim Palët:

Të sigurt se bashkëpunimi ndër institucional është vendimtar në arritjen e objektivave të përbashkëta, për të garantuar një mjedis të sigurt për fëmijët në hapësirën digjitale;

Duke konstatuar ritmin e shpejtë të përparimit të teknologjisë mund të ndryshojë dhe dinamika e rreziqeve në hapësirën kibernetike, si rrjedhojë dëgjohet mbi ndryshimet e mundshme të marrëveshjes përshtatur sipas kërcënimeve në zhvillim;

Duke qenë të ndërgjegjshëm se mbrojtja e fëmijëve në hapësirën digjitale është e pamjaftueshme, vetëm nëpërmjet përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor, për të dhënë gjithë përgjigjet dhe garancitë e kërkuara, për shkak të dinamikës së rreziqeve.

Duke vlerësuar mbrojtjen që ligji i jep fëmijëve në hapësirën digjitale për sigurinë e tyre nga kërcënimet/sulmet kibernetike, me anë të këtij bashkëpunimi do të reflektojmë respektimin e parimit të reciprocitetit ndërmjet dy autoriteteve.

Neni 1 QËLLIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit, ndërmjet dy institucioneve, në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në hapësirën kibernetike.

Neni 2 OBJEKTI

Kjo marrëveshje përcakton mënyrën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit, brenda kompetencave ligjore të palëve sipas veprimtarisë përkatëse, për të arritur qëllimet e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 3 BAZA LIGJORE

Palët do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet që do të ndërmarrin, me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga:

- a. Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- b. Ligjin nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”;
- c. Ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik” i ndryshuar;
- d. Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- e. Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar;
- f. VKM Nr. 1084, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të veprimit 2020-2025”;
- g. Vendimin nr. 659, datë 03.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026”;
- h. VKM nr. 141, datë 22.2.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” i ndryshuar;
- i. VKM nr. 635, datë 25.09.2019 “Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;

NENI 4 ANGAZHIMET E PALËVE DHE FUSHA E BASHKËPUNIMIT

Për të arritur qëllimin e mësipërm të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, Palët synojnë të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

- a) të angazhohen në krijimin e një bashkëpunimi ndërinstitucional duke përfshirë edhe aktorë të tjerë publik dhe privat për promovimin e kulturës së Internetit të Sigurt;

- b) të krijojnë sinergji mes dy institucioneve për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve në hapësirën kibernetike;
- c) të angazhohen dhe të koordinohen në përmbushjen e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta që janë përfshirë në kuadër të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, Planit të Veprimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021-2026 dhe çdo aktivitet tjetër që dakordësohen nga palët;
- d) të konsultohen, informojnë dhe t'i raportojnë njëra-tjetrës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre për trajtimin e rasteve me përmbajtje të paligjshme në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e fëmijës dhe përmbushja korrekte e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi;
- e) të angazhohen në organizimin e fushatave ndërgjegjësuese, trajnimeve, konferencave dhe publikimeve të materialeve edukative, me kontribut të dakordësuar të të dy palëve, lidhur me mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së fëmijëve dhe të rinjve;
- f) të bashkëpunojnë me anë të grupeve të punës, për të dhënë mendim në hartimin e udhëzimeve për ndërtimin e instrumenteve ligjore dhe teknike për sigurinë online të fëmijëve dhe të rinjve;
- g) të krijojnë ura bashkëpunimi për të siguruar një informim aktiv nëpërmjet publikimit në faqet zyrtare të mediave sociale të palëve dhe në mediat audio-vizive;
- h) palët duhet të organizojnë, të paktën dy herë në vit, takime të përbashkëta mes titullarëve apo përfaqësuesve për diskutime mbi ecurinë, vazhdimësinë dhe plotësimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje dhe Planit të Përbashkët të Punës (Aneks I), ose në çdo rast që çmohet e nevojshme.
- i) palët mbeten përgjegjëse të zhvillojnë aktivitete dhe në mënyrë të pavarur, në kuadër të përmbushjes së objektivave të tyre strategjike .

Neni 5

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

1. Palët shkëmbejnë informacionin me rëndësi për aq sa lejohet nga legjislacioni në fuqi, si dhe për të përmbushur qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, ndërsa për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror, palët do të zbatojnë dispozitat sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.
2. Shkëmbimi i informacionit midis Palëve do të bëhet me mjete të sigurta komunikimi me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit të tyre.

Neni 6

PERSONI I KONTAKTIT

1. Palët në zbatim të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të caktojnë nga një person kontakti.

2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, postë elektronike zyrtare, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Secila palë, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje njofton me shkrim për personin e kontaktit.

Neni 7

ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMI

Mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet Palëve në lidhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

Neni 8

DISPOZITAT E FUNDIT

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Planit të Përbashkët të Punës (Aneks 1)
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar.
3. Secila nga Palët mund të ndërpresë angazhimin e saj sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, duke njoftuar me shkrim 30 (tridhjetë) ditë para Palën tjetër.
4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet ose plotësohet në çdo kohë me pëlqim të ndërsjellë me shkrim të Palëve.
5. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi me Nënshkrimin e palëve pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.


Neni 9

INFORMACIONET E KONTAKTIT

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS	AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE
Emër: Anila Bregu	Emër: Ariana Ylli
Institucioni: ASHDMF	Institucioni: AKCESK
Telefon: +3554500329	Telefon: +3554-22-21039
Adresë e-mail: Info@femjet.gov.al	Adresë e-mail: info@cesk.gov.al
Adresa: Tiranë, Shqipëri	Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I, Tiranë

Nënshkruar në Tiranë, më datë 06.02.2024, në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

PËR
AGJENCINË SHTETËRORE PËR
TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS



PËR
AUTORITETIN KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

